

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Nr.4 Tiranë

PROGRAMI

I KURSIT TË VECANTË

“HEKURPUNIM”

Kodi: H-20

Miratoi

DREJTOR

.....

Tiranë, 2020

POGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“HEKURPUNIM”

(Kodi: H -20)

I. Profili Profesional i Hekurpunuesit.

a) Karakteristikat kryesore të Hekurpunuesit.

Hekurpunuesi është i aftë të kryejë detyra profesionale si i punësuar apo i vetëpunësuar në ndërmarrje, në kantiere ndërtimi dhe punishte.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, hekurpunuesi duhet që të zotërojë njohuri profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe shprehni profesionale që lidhen me veprimtaritë profesionale në prodhimet e hekurpunimit.

Hekurpunuesi do të jetë i aftë të kryejë punime të hekurit në gjëndje të ftohtë dhe të nxehtë për të prodhuar objekte të ndryshme prej hekuri si: struktura prej hekuri, objekte të ndryshme prej hekuri, mobilie prej hekuri dhe objekte dekorative.

Për realizimin me sukses të detyrave, hekurpunuesi duhet që të zotërojë njohuri që kanë të bëjnë me fenomenet që ndodhin gjatë procesit të punimit të hekurit, si dhe **shprehi** praktike që lidhen me matjet e thjeshta dhe skicimet, me operacionet kryesore të farkëtimit(shtrirja, prerja, trashimi, shpimi, përkulja dhe saldimi), etj..

Suksesi i hekurpunuesit është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit të Hekurpunuesit dhe karriera profesionale e tij.

Profesioni i hekurpunuesit është i lidhur ngushtë me prodhimet e mobiljeve, strukturave dhe objekteve të ndryshme, punimeve dekorative prej hekuri etj. Ai mund të punësohet në ndërmarrje ose biznese që kryejnë veprimtari të tilla, si kantiere ndërtimi, punishte etj., ose mund të vetëpunësohet.

Hekurpunuesi i ka mundësitë për të përparuar në këtë profesion duke kaluar në faza të ndryshme: ndihmës hekurpunues dhe mjeshtër artizanal për punimet me hekur. Me kualifikime të mëtijshme në shkolla profesionale apo trajnimin nëpërmjet punës, hekurpunuesi mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse, duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm në fushën e mekanikës. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit mekanik. Për të zhvilluar aktivitetin privat në fushën e shërbimeve që lidhen me hekurpunimin, duhet regjistrim për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas ligjit.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Hekurpunim”.

Në përfundin të Kursit për “Hekurpunim”, kursanti do të jetë i aftë:

- të përzgjedhë dhe përdorë mjetet, pajisjet, materialet e duhura të punës së hekurpunuesit;
- të kryejë llogaritje të sipërfaqeve dhe perimetrit të formave gjeometrike në materiale të ndryshme;
- të përgatisë skica të thjeshta të mobiljeve dhe objekteve;
- të kryejë saldime me hark elektrik, sipas llojit dhe pozicionit të materialeve(hekur); të kontrollojë dhe axhustojë saldimin me hark elektrik në punimet e hekurpunuesit;
- të kryejë operacionet kryesore të punimit të hekurit;

- të përpunojë hekurin në gjendje të nxehtë(shtrirja, prerja, trashimi, shpimi,përkulja dhe saldimi);
- të përpunojë hekurin në gjendje të ftohtë(prerja, drejtimi, shpimi, ngjitja, kthimi);
- të përgatisë elementet për prodhimin e mobiljeve, strukturave dhe objekteve të ndryshme prej hekuri;
- të prodhojë mobiljet prej hekuri;
- të prodhojë objekte të ndryshme prej hekuri;
- të prodhojë struktura prej hekuri;
- të realizojë punime dekorative prej hekuri;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punimet e kryera;
- të zbatojë standardet e profesionit gjatë prodhimit të mobiljeve dhe objekteve prej hekuri;
- të komunikojë me etikë me eprorët, kolegët dhe klientët;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në mjediset e punës.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Hekurpunim”.

250 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

IV. Kërkesat e pranimit për Kursin “Hekurpunim”.

Pjesëmarrësit në Kursin “Hekurpunim”, duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç.

V. Informacion për Modulet e Kursit “Hekurpunim”.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e hekurpunuesit	H-01-20	20 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori 20% Praktikë 10%Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të hekurpunuesit. 2. Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet, instrumentet dhe materialet që përdoren në hekurpunim. 3. Kursanti kryen llogaritje të sipërfaqeve dhe perimetrit të formave gjeometrike në materiale të ndryshme. 4. Kursanti përgatit skica të thjeshta të objekteve. 5. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

2	Saldimi me hark elektrik në punimet e hekurpunuesit.	H-02-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10%Vlerësime	1. Kursanti përshkruan proceset e saldimit me hark elektrik. 2. Kursanti kryen saldime me hark elektrik, sipas llojit dhe pozicionit të materialeve(hekur) për punimet e hekurpunuesit. 3. Kursanti kontrollon dhe axhuston saldimin me hark elektrik, të punimeve të hekurpunuesit.
3	Operacionet kryesore të punimit të hekurit.	H-03-20	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10%Vlerësime	1. Kursanti përshkruan llojet dhe vecoritë e operacioneve kryesore të punimit të hekurit. 2. Kursanti kryen operacionet kryesore të farkëtimit. 3. Kursanti përpunon hekurin në gjendje të nxehtë. 4. Kursanti përpunon hekurin në gjendje të ftohtë.
4	Prodhimi i mobiljeve prej hekuri.	H-04-20	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10%Vlerësime	1. Kursanti kryen veprime parapërgatitore për prodhimin e mobiljeve prej hekuri. 2. Kursanti përgatit elementet për prodhimin e mobiljeve prej hekuri. 3. Kursanti prodhon mobiljet prej hekuri.
5	Prodhimi i strukturave dhe i objekteve të ndryshme prej hekuri.	H-05-20	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 70% Praktikë 10%Vlerësime	1. Kursanti kryen veprime përgatitore për prodhimin e strukturave dhe objekteve të ndryshme prej hekuri. 2. Kursanti përgatit elementet për prodhimin e strukturave dhe objekteve të ndryshme prej hekuri. 3. Kursanti prodhon objekte(kangjella, porta e etj.) prej hekuri. 4. Kursanti prodhon struktura(kapriata, skeleri, shkallë rreziku e etj.) prej hekuri.
6	Realizimi i punimeve dekorative prej hekuri.	H-06-20	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10%Vlerësime	1. Kursanti kryen veprime parapërgatitore për punimet dekorative prej hekuri. 2. Kursanti realizon punime dekorative prej hekuri.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik. Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit “Hekurpunim”:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e hekurpunuesit”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E HEKURPUNUESIT.	H-01-20
Qëllimi moduli	i Një modul teoriko- praktik që i njeh kursantët me veçoritë, funksionet, detyrat dhe kërkesat e profesionit të hekurpunuesit, me mjedisin, veglat, pajisjet, instrumentat dhe materialet e punës, me rregullat e sigurimit teknik, si dhe i aftëson ata për llogaritjet e sipërfaqeve dhe të perimetrit të formave gjeometrike, për përgatitjen e skicave që përdoren në hekurpunim.	
Kohëzgjatja moduli	e 20 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori; 20% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli parapëlqyer për pranim	i Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të hekurpunuesit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë vendin dhe kushtet e punës së hekurpunuesit; - të tregojë cilat janë kërkesat profesionale të hekurpunuesit; - të tregojë cilat janë prodhimet kryesore të hekurpunimit; - të rendisë detyrat kryesore të hekurpunimit; - të shpjegojë mundësitë e përparimit në profesionin e hekurpunuesit; - të tregojë mundësitë e punësimit të hekurpunuesit; - të përshkruajë kërkesat për liçensim për ushtrimin e veprimtarisë hekurpunuesit; - të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit; Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim	

RM 2 Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet, instrumentet dhe materialet që përdoren në hekurpunim.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë mjedisin e punës së hekurpunuesit;
- të listojë veglat që përdoren në hekurpunim;
- të përshkruajë përdorimin e veglave;
- të përshkruajë kujdesin dhe mirëmbajtjen ndaj veglave;
- të dallojë pajisjet që përdoren në hekurpunim;
- të tregojë përdorimin e pajisjeve të hekurpunimit;
- të përshkruajë rregullat e kujdesit dhe të mirëmbajtjes ndaj pajisjeve të hekurpunimit;
- të tregojë përdorimin e instrumentave matëse dhe kontrolluese;
- të përshkruajë kujdesin dhe mirëmbajtjen ndaj instrumentave matëse dhe kontrolluese;
- të dallojë veglat kryesore nga veglat ndihmëse;
- të përshkruajë materialet që përdoren në hekurpunim;
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 3 Kursanti kryen llogaritje të sipërfaqeve dhe perimetrit të formave gjeometrike në materiale të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë funksionet e figurave gjeometrike;
- të realizojë figura gjeometrike me materiale të dimensioneve të ndryshme;
- për llogarsië saktë distancat dhe format sipas koncepteve gjeometrike;
- të bëjë llogaritje perimetrike të figurave gjeometrike me materiale të ndryshme;
- të bëjë llogaritje të sipërfaqeve me materiale të ndryshme;
- të bëjë llogaritjen totale të materialeve që duhen për prodhimin e një objekti metalik;
- të përshkruajë mjetet matëse dhe kontrolluese për realizimin e objektit, strukturës, mobilies;
- të përdorë saktë procedurën për përdorimin e shkallës së zvogëlimit dhe të zmadhimit të një imazhi/figure.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje-përgjigje me shkrim

RM 4 Kursanti përgatit skica të thjeshta të objekteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të lexojë dhe interpretojë skica të thjeshta të objekteve;
- të tregojë veçoritë e skicave të objekteve të ndryshme të hekurpunimit;
- të respektojë rregullat e skicimit të objekteve të ndryshme të hekurpunimit;
- të kryejë skicimin e objekteve të thjeshta, tipike të hekurpunimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 5 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë rregulloren e sigurimit teknik;
- të përcaktojë rreziqet kryesore që mund të ndodhin;
- të përcaktojë shkaqet e rreziqeve të mundshme;
- të përcaktojë masat dhe veprimet për menjanimin e rreziqeve të mundshme;
- të përcaktojë pasojat nga moszbatimi i rregullores së sigurimit teknik;
- të përcaktojë, në përputhje me standardet e miratuara, masat dhe veprimet e dhënies së ndihmës së parë sipas rasteve konkrete;
- të përcaktojë masat dhe veprimet që ndërmerren në rast rreziku nga rryma elektrike, sipas rregullores së sigurimit teknik;
- të përcaktojë masat dhe veprimet që ndërmerren në rast rreziku nga përmytjet, sipas rregullores së sigurimit teknik;
- të përcaktojë masat dhe veprimet që ndërmerren në rast rreziku nga zjarri, sipas rregullores së sigurimit teknik;
- të përcaktojë, në përputhje me standardet e miratuara, masat dhe veprimet e dhënies së ndihmës së parë sipas rasteve konkrete;
- të përshkruajë masat për ruajtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarive profesionale të mobilierit;
- të planifikojë masat e sigurisë në punë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin Hekurpunuesit dhe në mjediset e punës të hekurpunuesit.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete gjatë shpjegimit të veçorive të profesionit të hekurpunuesit si dhe të njohjes së kursantëve me mjetet e punës, lëndët e para dhe prodhimet në hekurpunim dhe

	me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.
	- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë për teorinë. - Repart hekurpunimi. - Komploti i veglave, pajisjeve dhe instrumentave që përdoren në hekurpunim. - Lëndë të para dhe materiale të tjera që përdoren në hekurpunim. - Pankarta, makete, kataloge të prodhimeve të hekurpunimit. - Materiale të shkruara - Manuale, rregullore dhe katalogë.

2. Moduli “Saldimi me hark elektrik në punimet e hekurpunuesit”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SALDIMI ME HARK ELEKTRIK NË PUNIMET E HEKURPUNUESIT.	H-02-20
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson kursantët në përdorimin e aparateve të saldimit me hark elektrik, si dhe për të realizuar pikime, mbushje, kontrolle dhe axhustime me saldimit me hark elektrik për punimet e hekurit.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë përfunduar Modulin 1 “Hyrje në profesionin e hekurpunuesit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan proceset e saldimit me hark elektrik. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të shpjegojë nocionet themelore të saldimit me hark elektrik me dorë me elektrodë të mbështjellë; - të përshkruajë llojet dhe veçoritë e tegelave të saldimit me hark elektrik; - të listojë përparësitë dhe të metat e saldimit me hark elektrik; - të shpjegojë skemën elektrike të saldimit me hark	

elektrik;

- të shpjegojë procesin e saldimit me hark elektrik me dorë me elektrodë të mbështjellë;
- të shpjegojë harkun elektrik dhe efektet e tij gjatë saldimit;
- të listojë dhe përshkruajë teknikat e saldimit dhe llojet e tegelave të saldimit me hark elektrik;
- të listojë veglat dhe pajisjet për saldimin me hark elektrik;
- të përshkruajë ndërtimin e pajisjeve për saldimin me hark elektrik;
- të përshkruajë parametrat e regjimit të saldimit me hark elektrik;
- të listojë llojet e elektrodave për saldimin me hark elektrik, marketimin dhe përdorimet e tyre;
- të tregojë si rregullohen regjimet e saldimit me hark elektrik;
- të përgatisë vendin dhe pajisjet e punës për saldimin me hark elektrik;
- të përshkruajë procedurat e parapërgatitjes së detaleve për saldimin me hark dhe rëndësinë e saj;
- të përshkruajë mënyrat e pozicionimit dhe të fiksimit të detaleve për saldimin me hark elektrik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 2 Kursanti kryen saldime me hark elektrik, sipas llojit dhe pozicionit të materialeve(hekur) për punimet e hekurpunuesit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse për saldim me hark elektrik;
- të përgatisë dhe analizojë materialin për pikim;
- të parapërgatisë pjesët metalike për pikim;
- të pozicionojë dhe fiksojë pjesët metalike për pikim;
- të përshtatë regjimin e makinës së saldimit me hark, për pikim;
- të përzgjedhë elektrodën për pikimin;
- të kryejë pikimin e pjeseve të ndryshme metalike;
- të kryejë saldime horizontale me tegel të plotë;
- të kryejë saldime në mbi një, me hark elektrik;
- të kryejë saldime këndore me hark elektrik;
- të kryejë saldime në pozicione vertikale me hark elektrik;
- të kryejë saldime në pozicione horizontale me hark elektrik;
- të kryejë saldime në pozicione tavanore me hark elektrik;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e

- punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë pikimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti kontrollon dhe axhuston saldimin me hark elektrik, të punimeve të hekurpunuesit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse për kontrollin dhe axhustimin e saldimit;
- të analizojë saldimin e kryer;
- të bëjë pastrimin e zgjyrës nga tegelat me çekanin e saldatorit dhe furçë çeliku;
- të përcaktojë gabimet në saldimet një mbi një, ballore dhe këndore, duke përdorur shikimin;
- të përcaktojë gabimet në tegelat e saldimit, pas pastrimit të zgjyrës;
- të axhustojë siç duhet sipërfaqet e salduara, me përdorim të gurit zmerilues;
- të axhustojë si duhet sipërfaqet e salduara, me përdorim të letrës zmeriluese;
- të axhustojë sipërfaqet e salduara, me përdorim të limës;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të kontrollit e finalizimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit	Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin e hekurpunimit dhe në mjediset e punës të hekurpunuesit. Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete gjatë proceseve të saldimit me hark elektrik, të përdorimit të veglave, pajisjeve dhe të zbatimit të rregullave të sigurimit teknik. Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin e modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë për teorinë. - Repart saldimi.

- Komploti i veglave, pajisjeve dhe instrumentave që përdoren në hekurpunim.
- Lëndë të para dhe materiale të tjera që përdoren në saldim.
- Pankarta, makete, katalogje të prodhimeve të saldimit.
- Materiale të shkruara (manuale, rregullore, katalogë e etj.).

3. Moduli “Operacionet kryesore të punimit të hekurit ”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	OPERACIONET KRYESORE TË PUNIMIT TË HEKURIT.	H-03-20
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko- praktik që i njeh kursantët me vecoritë e farkëtimit dhe materialeve, si dhe i aftëson ata për të përpunuar(, drejtim, shtrirje, prerje, trashim, shpimi, përkulja, petëzimi) hekurin në gjendje të nxehtë dhe të ftohtë.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyrues, të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë përfunduar Modulin 1 “Hyrje në profesionin e hekurpunuesit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan llojet dhe vecoritë e operacioneve kryesore të punimit të hekurit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë llojet e operacioneve kryesore të punimit të hekurit; - të përshkruajë materialet(hekur, çelik) që përdoren për operacionet kryesore të punimit të hekurit; - të përshkruajë vetitë e hekurit dhe çelikut; - të shpjegojë kuptimin mbi shformimin plastik të metalit; - të shpjegojë pasojat që sjell farkëtimi në pjesë të nxehta të hekurit mbi temperaturën maksimale; - të përshkruajë faktorët që ndikojnë në nxehjen e metalit; - të përshkruajë ndërtimin e pajisjes nxehëse (farkës); - të përshkruajë veçoritë e nxehjes së metalit në farkë; - të përshkruajë efektet e metalit gjatë ftohjes dhe pas farkëtueshmërisë; - të përshkruajë rregullat e mirëmbajtjes së veglave, mjeteve të punës; - të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës dhe pas mbarimit të punës. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë	

-
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 2 Kursanti kryen operacionet kryesore të farkëtimit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë bazën materiale të nevojshme për të gjitha operacionet e farkëtimit;
- të përgatisë veglat e nevojshme të punës për të gjitha operacionet e farkëtimit;
- të organizojë vendin e punës së farkëtarit;
- të shtrijë metalin në gjerësi dhe gjatësi;
- të presë metalin në gjendje të ftohtë dhe të nxehtë;
- të bëjë trashimin e metalit në pjesë të ndryshme të metalit;
- të bëjë shpimin e metalit sipas teknikave të duhura;
- të bëjë përkuljen e metalit sipas teknikave të duhura;
- të bëjë saldimin me farkëtim sipas teknikave të duhura;
- të bëjë petëzimin e metalit sipas formës;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe mjetet e punës;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik gjatë operacioneve të ndryshme të farkëtimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti përpunon hekurin në gjendje të nxehtë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të organizojë vendin e punës në mënyrën e duhur;
- të përzgjedhë veglat e duhura për përpunimin e hekurit në gjendje të ftohtë;
- të përgatitë farkën për punë;
- të fiksojë kudhrën në vendin e punës;
- të mbajë hekurin në kudhër sipas teknikave të duhura;
- të realizojë goditjet e hekurit në kudhër sipas teknikave të duhura;
- të realizojë përpunimin e hekurit të nxehtë në morskë sipas teknikave të duhura;
- të bëjë përdredhjen e hekurit të nxehtë në morskë sipas teknikave të duhura;
- të bëjë petëzim, trashim, shpim dhe saldim në kudhër;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe mjetet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë përpunimit të hekurit në gjendje të nxehtë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti përpunon hekurin në gjendje të ftohtë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të organizojë si duhet vendin e punës;
- të përzgjedhë veglat e duhura për përpunimin e hekurit në gjendje të ftohtë;
- të realizojë prerjen e hekurit të ftohtë në mënyra të ndryshme (me disk bangoje, me fresibel, me sharrë dore);
- të punojë hekurin e ftohtë në morskë;
- të përdorë si duhet veglat matëse dhe kontrolluese;
- të punojë hekurin e ftohtë në kudhër;
- të zbatojë teknikat e duhura për perdredhjen, harkimin, drejtimin, shpimin e hekurit;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe mjetet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë përpunimit të hekurit në gjendje të ftohtë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë ose në repartin e hekurpunuesit. Rekomandohet vizita mësimore në ndërmarrje apo biznese ku kryhen përpunime të hekurit.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime të fenomeneve që trajton.
- Kursantët duhet të nxiten që të bëjnë pyetje që lidhen me procesin dhe procedurat e punës dhe të diskutojnë në lidhje me to.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet theksi me tepër tek interpretimi i njohurive, koncepteve dhe fenomeneve, se sa tek riprodhimi mekanik i tyre.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë për trajtimin e çështjeve teorike.
 - Kabinet për trajtimin e çështjeve praktike.
 - Farkë, kudhër, qymyr druri, copa metalesh, çekiç, masha të llojeve të ndryshme, vegla matëse kontrolluese.
 - Rregullore, udhëzues, manuale për farkëtimin e metaleve.
-

4. Moduli “Prodhimi i mobiljeve prej hekuri”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kod	PRODHIMI I MOBILJEVE PREJ HEKURI.	H-04-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët për të prodhuar mobilje të ndryshme prej hekuri si: karrige, poltrone, tavolina, krevate, korniza e etj.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë përfunduar Modulin 1 “Hyrje ne profesionin e hekurpunuesit”, Modulin 2 ”Saldimi me hark elektrik ne punimet e hekurpunuesit”, Modulin 3 “Operacionet kryesore të punimit të hekurit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti kryen veprime parapërgatitore për prodhimin e mobiljeve prej hekuri. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të rikujtojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit; - të organizojë vendin e punës për prodhimin e mobiljeve prej hekuri; - të bëjë skicimin mobiljeve prej hekuri; - të zbërthejë saktë skicat e mobiljeve prej hekuri; - të përzgjedhë saktë materialet për prodhimin e mobiljeve prej hekuri; - të përlogarisë bazën materiale të nevojshme për prodhimin e mobiljes prej hekuri; - të përzgjedhë drejt veglat, pajisjet dhe makinat që nevojiten për prodhimin e mobiljeve prej hekuri; - të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje -përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli	
	RM 2 Kursanti përgatit elementet për prodhimin e mobiljeve prej hekuri. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të masë dhe të shënojë mbi hekur sipas përmasave të kërkuara për prodhimin e mobiljeve; - të shkurtojë materialin me mbishtesat e kërkuara me veglat e shkurtimit; - të drejtojë materialin e shkurtuar në kudhër; - të punojë elementet e mobiljes në gjendje të nxehtë dhe të ftohtë sipas skicës; - të shkurtojë në përmasat fikse elementët e mobiljes sipas	

- formës së duhur me fresibël, disk bangoje ose sharrë dore;
- të bëjë shënime mbi elementët për shpimin e tyre;
- të shpojë elementët me trapan dore ose me trapan bangoje;
- të lakojë elementët me morse bangoje;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe mjetet e punës.
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve, për përgatitjen e elementeve të mobiljeve prej hekuri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontroll

RM 3 Kursanti prodhon mobiljet prej hekuri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të fiksojë elementet e mobiljes prej hekuri me morseta dore;
- të evidentojë gabimet e mundshme;
- të korrigjojë gabimet e evidentuara;
- të lidhë elementët me anë procesit të pikimit;
- të kontrollojë elementët e lidhur;
- të bëjë mbushjen me saldim të gjithë pjesëve të lidhura;
- të axhustojë me gurë fresibël;
- të bëjë pastrimin me limë dhe furçë teli;
- të stukojojë dhe të pastrojë me letër zmeril;
- të kryejë veprime parapërgatitore për lyerjen;
- të lyejë mobiljet me kompresor dhe pistoletë;
- të lyejë mobiljet me rrul dhe penel;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe mjetet e punës;
- të realizojë llogaritjen e shpenzimeve për materialet dhe punën e kryer;
- të plotësojë dokumentet financiare për shërbimin e kryer;
- të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve, për përgatitjen e elementeve të mobiljeve prej hekuri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale të përpunimit të hekurit(punishte). Rekomandohet kryerja e vizitave mësimore dhe praktikimi i kursantëve në biznese lokale që kryejnë punime të hekurit.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete për matje, shënime, shkurtime, sharrime dhe montimin e mobiljeve prej hekuri.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për matje, shënime, shkurtime, sharrime dhe montimin e

	mobiljeve prej hekuri, në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për prodhimin e mobiljeve prej hekuri. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e prodhimit të mobiljeve prej hekuri. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: - Mjedise të praktikës së përpunimit të hekurit me poste pune, për matjen dhe prejen e lëndës së parë. - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punime hekuri. - Lëndë e parë. - Aksesore të ndryshëm. - Katallogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

5. Moduli “Prodhimi i strukturave dhe i objekteve të ndryshme prej hekuri”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PRODHIMI I STRUKTURAVE DHE I OBJEKTEVE TË NDRYSHME PREJ HEKURI.	H-05-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët për të prodhuar struktura dhe objekte të ndryshme të jashtme prej hekuri si: kapriata, skeleri, shkallë rreziku, kangjella, porta e etj..	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë përfunduar Modulin 1 “Hyrje në profesionin e hekurpunuesit”, Modulin 2 “Saldimi me hark elektrik në punimet e hekurpunuesit”, Modulin 3 “Operacionet kryesore të punimit të hekurit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti kryen veprime përgatitore për prodhimin e strukturave dhe objekteve të ndryshme prej hekuri. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të rikujtojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit; - të organizojë vendin e punës për prodhimin e strukturave dhe objekteve të ndryshme prej hekuri;	

-
- të bëjë skicimin e strukturës ose objektit;
 - të zbërthejë sakt skicat e strukturave dhe objekteve të ndryshme;
 - të përzgjedhë sakt materialet për prodhimin e strukturave dhe objekteve të ndryshme;
 - të përlllogarisë bazën materiale të nevojshme për prodhimin e strukturës dhe objekteve prej hekuri;
 - të përzgjedhë drejt veglat, pajisjet dhe makinat që nevojiten për prodhimin e strukturës dhe objektit prej hekuri;
 - të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje -përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 2 Kursanti përgatit elementet për prodhimin e strukturave dhe objekteve të ndryshme prej hekuri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të masë dhe të shënojë mbi hekur sipas përmasave të kërkuara për prodhimin e strukturave dhe objekteve të ndryshme prej hekuri;
- të shkurtojë materialin me mbishtesat e kërkuara me veglat e shkurtimit;
- të drejtojë materialin e shkurtuar në kudhër ;
- të punojë elementet e strukturës dhe objektit;
- të shkurtojë në përmasa fikse elementët e strukturës sipas formës së duhur me fresibël, disk bangoje ose sharrë dore;
- të bëjë shënime mbi elementët për shpimin e tyre;
- të shpojë elementët me trapan dore ose me trapan bangoje;
- të lakojë elementët me morse bangoje;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe mjetet e punës;
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve, për përgatitjen e elementeve të strukturave dhe objekteve prej hekuri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontroll

RM 3 Kursanti prodhon objekte(kangjella, porta e etj.) prej hekuri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të fiksojë elementet e objekteve prej hekuri;
- të evidentojë gabimet e mundshme;
- të korrigjojë gabimet e evidentuara;
- të lidhë elementët me anë të procesit të pikimit;
- të kontrollojë elementët e lidhura;
- të bëjë mbushjen me saldim të pjesëve të lidhura;

- të axhustojë me gurë fresibël, diskë letër fresibël;
- të kryejë veprime parapërgatitore për lyejen;
- të lyejë objektin me kompresor dhe pistoletë;
- të lyejë objektin me rrul dhe penel;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe mjetet e punës;
- të realizojë llogaritjen e shpenzimeve për materialet dhe punën e kryer;
- të plotësojë faturën financiare për shërbimin e kryer;
- të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët;
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve, për përgatitjen e elementeve të objekteve prej hekuri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti prodhon struktura(kapriata, skeleri, shkallë rreziku e etj.) prej hekuri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të fiksojë elementet e stukturës prej hekuri;
- të evidentojë gabimet e mundshme;
- të korrigjojë gabimet e evidentuara;
- të lidhë elementët me anë të procesit të pikimit;
- të kontrollojë elementët e lidhura;
- të bëjë mbushjen me saldim të pjesëve të lidhura;
- të axhustojë me gurë fresibël, diskë letër fresibël;
- të kryejë veprime parapërgatitore për lyejen;
- të lyejë strukturën me kompresor dhe pistoletë;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe mjetet e punës;
- të realizojë llogaritjen e shpenzimeve për materialet dhe punën e kryer;
- të plotësojë faturën financiare për shërbimin e kryer;
- të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët;
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve, për përgatitjen e elementeve të strukturave prej hekuri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale të përpunimit të hekurit (punishte). Rekomandohet kryerja e vizitave mësimore dhe praktikim i kursantëve në biznese lokale që kryejnë punime hekuri.

Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete si në matje, shënime, shkurtime, sharrime dhe montimin e mobiljeve prej druri.

Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për

		kryerjen e punimeve në matje, shënime, shkurtime, sharrime dhe montimin e mobiljeve prej hekuri, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për prodhimin e mobiljeve prej hekuri. Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për realizimin e prodhimit të mobiljeve prej hekuri. Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet domosdoshme për realizimin e modulit	e	Për realizimin e modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Mjedise të praktikës së përpunimit të hekurit me poste pune, për matjen dhe prejen e lëndës së parë. - Komploti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punime hekuri. - Lëndë e parë. - Aksesore të ndryshëm. - Katallogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

6. Moduli “Realizimi i punimeve dekorative prej hekuri”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	REALIZIMI I PUNIMEVE DEKORATIVE PREJ HEKURI.	H-06-20
Qëllimi i modulit	i	Një modul praktik që i aftëson kursantët për të realizuar punime të imta dekorative prej hekuri si instalacione, silueta dhe shandane për zbukurimet e ambienteve të brendshme dhe të jashtme.
Kohëzgjatja e modulit	e	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime
Niveli i parapëlqyer për pranim	i	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë përfunduar Modulin 1 “Hyrje në profesionin e hekurpunuesit”, Modulin 2 “Saldimi me hark elektrik në punimet e hekurpunuesit”, Modulin 3 “Operacionet kryesore të punimit të hekurit”.
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Kursanti kryen veprime parapërgatitore për punimet dekorative prej hekuri. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë stilet klasike, neoklasike, rokoko, baroke dhe kontemporane; - të stilojë punimet dekorative të ndryshme;

-
- të rikujtojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit;
 - të organizojë vendin e punës për prodhimin e punimeve dekorative prej hekuri;
 - të zbërthejë skicat e punimeve dekorative prej hekuri;
 - të përzgjedhë materialet për prodhimin e punimeve dekorative prej hekuri;
 - të përzgjedhë drejt veglat, pajisjet që nevojiten për prodhimin e punimeve prej hekuri;
 - të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje -përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 2 Kursanti realizon punime dekorative prej hekuri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të masë dhe të shënojë mbi materialin hekur sipas përmasave të kërkuara;
- të shkurtojë materialin me mbishtesat e kërkuara në makinat e shkurtimit;
- të drejtojë materialin e shkurtuar;
- të sharrojë materialin;
- të punojë hekurin në gjendje të nxehtë dhe të ftohtë ;
- të lidhë elementët me anë të procesit të pikimit;
- të kontrollojë elementët e lidhura;
- të bëjë mbushjen me saldim të pjesëve të lidhura;
- të axhustojë me gurë fresibël, diskë letër fresibël;
- të kryejë veprime parapërgatitore për lyerjen;
- të lyejë punimet dekorative me kompresor dhe pistoletë;
- të lyejë punimet dekorative me rrul dhe penel;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe mjetet e punës.
- të realizojë llogaritjen e shpenzimeve për materialet dhe punën e kryer.
- të plotësojë faturën financiare për shërbimin e kryer;
- të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve, për përgatitjen e punimeve dekorative prej hekuri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale të përpunimit të hekurit (punishte). Rekomandohet kryerja e vizitave mësimore dhe praktikimi i kursantëve në biznese lokale që kryejnë punime hekuri.

Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur

	demonstrime konkrete. Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për prodhimin e punimeve dekorative prej hekuri. Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për realizimin e prodhimit të mobiljeve prej hekuri. Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Mjedise të praktikës së përpunimit të hekurit me poste pune, për matjen dhe prejen e lëndës së parë. - Komploti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punime hekuri. - Lëndë e parë. - Aksesore të ndryshëm. - Katallogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.